



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 98 Akti

Nr. 616 Vendimi  
Tiranë, më 27.1.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 27.1.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Entela Shedula**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

### **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi raportet e paraqitura nga institucionet e vlerësimit lidhur me dy kriteret, me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Entela Shedula, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjqësor Kavajë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.11.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 16.11.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionerja Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt është caktuar z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

3. Me vendimin nr. 254, datë 4.6.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Entela Shedula, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjqësor Kavajë.

4. Ky vendim u ankimua nga subjekti i rivlerësimit dhe çështja kaloi për shqyrtim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në përfundim të të cilit, me vendimin nr. 35, datë 22.9.2022, u vendos:

- a) Të priset vendimi nr. 254, datë 4.6.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Entela Shedula.
- b) Të urdhërohet Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për vazhdimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Entela Shedula edhe për kriteret – kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

5. Mbështetur në këtë vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, trupi gjykues, me vendimin nr. 1, të datës 27.9.2022, vendosi të riçelë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Entela Shedula për të vijuar me rivlerësimin për dy kriteret, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

6. Bazuar në nenet 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim KLD).

7. **DSIK-ja** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar mbi *“përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Entela Shedula”*.

8. **KLD-ja** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës nr. 4, të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>2</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.

9. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 19.1.2023, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Entela Shedula, njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit administrativ në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Entela Shedula i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërja e trupit gjykues; si dhe përfundimi kryesisht i hetimit administrativ. Në datën 19.1.2023, për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, subjektit iu dha mundësia për t’u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

12. Znj. Entela Shedula u njoh me rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e figurës dhe kriterin profesional. Duke qenë se subjektit nuk i kishte kaluar barrë prove për gjetjet e Komisionit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

---

<sup>1</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, dërgohet raporti i DSIK-së.

<sup>2</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2018, dërguar nga KLD-ja.

13. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimet e bëra elektronikisht në datën 19.1. 2023.

14. Seanca dëgjimore për subjektin Entela Shedula u zhvillua në datën 25.1.2023 në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

15. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

16. Subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike;
- b) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- c) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLD-ja;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Entela Shedula, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Komisioni ka vijuar rivlerësimin për dy kriteret e tjera – kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **A. KONTROLLI I FIGURËS**

23. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

24. **DSIK-ja** ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016<sup>3</sup> mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Entela Shedula në detyrën e gjyqtarit.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

25. Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga DSIK-ja në vitin 2017 dhe nga informacioni i ardhur rezulton se nuk disponohen të dhëna për subjektin Entela Shedula.

26. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

### **Vlerësimi i Komisionit**

27. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Entela Shedula arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk ka rezultuar se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka plotësuar saktë deklaratën e figurës, si dhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **B. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

---

<sup>3</sup>Në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, është dërguar raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.4.2018, të KDZH-së.

28. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- raportit të vlerësimit me nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2018, për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Inspektorati i KLD-së;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

29. Subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë nga data 23.8.1996 e në vijim. Në datën 14.11.2011 delegohet si kryetare e kësaj gjykate dhe me vendimin nr. 96, datë 11.7.2014 të KLD-së emërohet kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Raporti i vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit të hartuar nga Inspektorati i KLD-së është bazuar mbi analizimin e të dhënave të rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

### **GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT**

30. Subjekti i rivlerësimit Entela Shedula, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në datën 27.1.2017, ka paraqitur në KLD formularin e vetëdeklarimit dhe dokumentet shoqëruese të formularit të vetëdeklarimit. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit konstatohet:

- Saktësia e formularit të vetëdeklarimit.

### **Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

31. Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore të llojit “vendim gjyqësor”. Të tria vendimet paraqiten të standardizuara në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës.

### **PËRSHKRIMI I DOSJEVE GJYQËSORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT**

Gjetjet nga vëzhgimi i këtyre pesë dosjeve përshkruhen si vijon:

#### **Dosja 1.**

32. Çështja penale nr. \*\*\* regj., datë 17.11.2014, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë kundër të pandehurës Xh.C, e akuzuar për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.1.2015.

33. Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtarja Entela Shedula në datën 20.1.2015 – pas 4 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

34. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka zgjatur gjithsej 2 muaj, në intervalin kohor 17.11.2014 - 16.1.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9-mujor të caktuar nga pika 5, germa “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

✓ Kohëzgjatja e gjykimit respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

35. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale. Në dosje gjendet vendimi për kalimin e çështjes penale në gjykim, aktet e njoftimit të palëve, si dhe provat shkresore. Të gjitha procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera sipas kërkesave të neneve 345/1 dhe 346 të Kodit të Procedurës Penale.

36. Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal sipas nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale. Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale, vendimi unifikues nr. 2, datë 29.1.2003, i Gjykatës së Lartë dhe vendimi nr. 4/2012 i Gjykatës Kushtetuese për gjykimin e shkurtuar.

## **Dosja 2**

37. Çështja penale nr. \*\*\* regj., datë 25.9.2015, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë kundër të pandehurit K.H, i akuzuar për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.2.2016.

38. Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtarja Entela Shedula në datën 12.2.2016 – pas 2 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

39. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka zgjatur gjithsej 4 muaj e 15 ditë, në intervalin kohor 25.9.2015 - 10.2.2016. Kjo kohëzgjatje është tej afatit standard 4-mujor të caktuar nga pika 5, germa “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Në tejkalimin e afatit ka ndikuar sjellja e palëve, që nuk është disiplinuar në nivelin e duhur nga gjykata. Kohëzgjatja e gjykimit nuk respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

40. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale. Në dosje gjendet vendimi për kalimin e çështjes penale në gjykim, aktet e njoftimit të palëve, si dhe provat shkresore. Të gjitha procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera sipas kërkesave të neneve 345/1 dhe 346 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, procesverbali është i nënshkruar nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtarja sipas nenit 345/2 të Kodit të Procedurës Penale. Dosja nuk është sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale penale, pasi aktet në dosje nuk janë të inventarizuara rregullisht. Kështu, në fillim janë vendosur diskutimet

përfundimtare të palëve e, më pas, aktet e njoftimit dhe procesverbalet gjyqësore, duke u bërë i vështirë shfrytëzimi i saj nga palët.

41. Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal sipas nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Disponohet për fajësinë e të pandehurit dhe caktimin e masës së dënimit me burgim, duke e zbritur dënimin me 1/3 për shkak të gjykimit të shkurtuar, ku tregohet edhe afati i fillimit të vuajtjes së këtij dënimi dhe lloji i sigurisë. Disponohet për shpenzimet procedurale, si dhe tregohet e drejta dhe afati i ankimit. Nga pikëpamja e strukturës, vendimi është i ndërtuar me paragrafë sipas analizës së provave dhe elementeve të figurës së veprës penale. Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale, vendimi unifikues nr. 2/2003 i Gjykatës së Lartë dhe vendimi nr. 4/2012 i Gjykatës Kushtetuese për gjykimin e shkurtuar.

### **Dosja 3.**

42. Çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 30.5.2015, që i përket paditësit E.A kundër të paditurës S.A, me objekt “zgjidhje e martesës dhe lënia e fëmijës për rritje dhe edukim”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.6.2015. Me vendimin e datës 7.5.2015, gjyqtarja Entela Shedula ka caktuar seancën përgatitore më 22.6.2015, ora 10:00.

43. Në dosje ndodhet e administruar edhe kërkesa e paditësit për heqjen dorë, e cila mban datën 22.6.2015 dhe është e nënshkruar nga paditësi dhe avokati i tij. Gjykata, në këto rrethana, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

44. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka zgjatur gjithsej 1 muaj e 15 ditë, në intervalin kohor 7.5.2015 - 22.6.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 4-mujor të caktuar nga pika 5, germa “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Gjyqtarja ka marrë masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

### **Dosja 4.**

45. Çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 7.5.2015, që i përket paditëses Q.Sh kundër të paditurve DRSSH Tiranë dhe Agjencia Kavajë, me objekt “shpalljen të pavërtetë të regjistrit themeltar të ish-kooperativës bujqësore R, sa i përket gjeneraliteteve”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.4.2016. Me vendimin e datës 7.5.2015, gjyqtarja Entela Shedula ka caktuar seancën përgatitore më 29.6.2015.

46. Në seancën e 10-të gjyqësore, të datës 22.4.2016, Gjykata ka shpallur vendimin nr. \*\*\*, me të cilin ka vendosur “rrezimin e padisë”.

47. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim paditësja. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.11.2016, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 22.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.*”



48. *Pranimin e padisë. Njohjen e pavërtetësisë së regjistrit themeltar nr. \*, faqe \*\*\* dhe \*\*\* të ish-kooperativës bujqësore R, për sa i përket gjeneraliteteve të paditëses, duke ia njohur vjetërsinë e punës në fletët e regjistrit të mësipërm paditëses Q.H.Sh të datëlindjes 25.6.1953”.*

49. Shkaku i cenimit të vendimit nga Gjykata e Apelit Durrës lidhet me mungesën e analizës së plotë të provave të marra në seancë, pasi nga fletët nr. \*\*\* dhe \*\*\* të regjistrit themeltar të punonjësve të ish-kooperativës bujqësore R, provohet se i përkasin paditëses.

50. Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari në sekretari në datën 25.4.2016, pas 3 ditëve nga shpallja, brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

51. Gjykimi për këtë padi nga subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka zgjatur gjithsej 11 muaj e 15 ditë, në intervalin kohor 7.5.2015 - 22.4.2016. Kjo kohëzgjatje është tej afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

52. Në raportin e KLD-së referohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes, ndonëse palët janë paraqitur në gjykim.

➤ Në lidhje me tejkalimin e afateve të gjykimit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

53. Në datën 28.1.2020, subjekti ka shpjeguar se gjatë periudhës 2015 – 2016 ka përballuar një ngarkesë tej asaj të parashikuar që duhet të ketë secili gjyqtar, pasi nga maji i vitit 2015 - 2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka punuar me dy gjyqtarë, nga katër gjyqtarë që ishin të përcaktuar në organikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke e vështirësuar në mënyrë të jashtëzakonshme funksionalitetin normal të gjykatës.

54. Gjykata e ka pasur të pamundur të zgjidhte çështjen për një afat kohor më të shkurtër për shkak të ngarkesës dhe të mosfunksionimit në kushte normale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Subjekti ka shpjeguar se duhet mbajtur në konsideratë fakti që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë gjykon një numër të lartë çështjesh penale, të cilat, për shkak të specifikave (kufizimit të lirisë), afateve të paraburgimit, imponojnë afate të ngutshme për shqyrtimin e tyre.

55. Subjekti ka referuar se gjykimi i kësaj çështjeje civile tej afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e” e aneksit të sistemit të vlerësimit, duke mos respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve të gjyqtares Entela Shedula. Subjekti, mbështetur në procesverbalet e seancave, ka shpjeguar se disa seanca janë shtyrë me kërkesë të vetë palës paditëse Q.Sh dhe përfaqësuesit të saj ligjor av. N. T., prandaj në vlerësimin e afateve kohore duhet pasur në vëmendje edhe sjellja e vetë paditëses. Gjykata ka bërë të gjitha përpjekjet për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke marrë masat për t’i garantuar

palës paditëse të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën për të qenë personalisht e pranishme dhe për t'u dëgjuar në gjykim.

### **Vlerësimi i Komisionit**

56. Komisioni vlerëson se tejkalimi i afateve të gjykimit është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese në vlerësimin e aftësive profesionale, duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën e lartë në punë për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve në gjykatë<sup>4</sup> shpjegimet e subjektit duken të arësyeshme.

### **Dosja 5.**

57. Çështja administrativo-penale nr. \*\*\* regj., datë 22.5.2014, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me objekt “vleftësimi i ligjshëm i arrestit dhe caktimi i masës së sigurimit ‘detyrim për paraqitje’ ndaj B.E për veprën penale ‘drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt’ e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 23.5.2014.

58. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk është ankimuar nga palët. Dosja aktualisht ndodhej e arkivuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim për paraqitje” janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Entela Shedula në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë në datën 27.5.2014 – pas 4 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

### **Vlerësimi i Komisionit**

59. Nga dosjet e vëzhguar, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr.96/2016.

### **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së**

60. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Entela Shedula janë paraqitur gjithsej 5 ankesa në Inspektoratin e KLD-së. Katër ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, dy prej të cilave me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe dy ankesa me arsyetimin se janë ankesa të paraqitura më parë.

61. Një ankesë e vitit 2014 është verifikuar për mungesë solemniteti dhe është sugjeruar “tërheqje vëmendje” me shkrim për gjyqtaren në lidhje me shkeljet e konstatuara. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Entela Shedula, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### **ANALIZA E GJETJEVE**

62. Analiza e gjetjeve është bazuar mbi analizimin e të dhënave të rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

---

<sup>4</sup> Subjekti në prapësime ka depozituar Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2023, dhe nr. \*\*\* prot, datë 20.07.2015 drejtuar Presidentit të Republikës.

## **Aftësitë profesionale**

### *a) Njohuritë ligjore*

63. Referuar raportit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në aktet e shqyrtuara është konstatuar se subjekti identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Në çështjet penale i kushton rëndësi të gjitha elementeve të veprës penale, si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal dhe alternativat e tij.

### *b) Arsyetimi ligjor*

64. Subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Arsyetimi i vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast që të jetë cenuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

## **Aftësitë organizative**

### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

65. Subjekti i rivlerësimit Entela Shedula, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në dhomën civile e penale.

66 .Sipas të dhënave statistikore, për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtarja Entela Shedula ka përfunduar gjithsej 1485 çështje gjyqësore, nga të cilat 209 penale, 565 kërkesa penale, 466 civile të përgjithshme dhe 245 kërkesa civile.

67. Bazuar në këto të dhëna konstatohet se gjyqtarja Entela Shedula ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ajo ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal, por i ka kushtuar rëndësinë e duhur gjykimit dhe arsyetimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore.

### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

68. Subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Gjatë gjykimit ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre.

## **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

### *a) Etika në punë*

69. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Entela Shedula përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Ndërsa nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative mbi etikën në punë të subjektit.

*b) Integriteti*

70. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*c) Paanësia*

71. Nga aktet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Entela Shedula. Në dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve.

**Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

*a) Aftësitë e komunikimit*

72. Në dosjet e vëzhguara, subjekti i rivlerësimit komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e saj.

*b) Aftësia për të bashkëpunuar*

73. Në aktet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Entela Shedula për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore.

*c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

74. Në periudhën e rivlerësimit subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në 16 trajnime në Shkollën e Magjistraturës.

**Hetimi i Komisionit në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi**

75. Komisioni, në datën 27.9.2022, pas riçeljes së hetimit ka hetuar mbi ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqëritë tregtare, administratorët/ortakët e tyre, ku ka qenë i punësuar bashkëshorti i subjektit, z. F.Sh, si vijon:

- a) shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., me NUIS K\*\*\*O, me administrator z. A.L;
- b) shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., me NUIS L\*\*\*U, me administrator z. I.S;
- c) shoqëria "\*\*\*\*", NUIS L\*\*\*V, me administrator znj. R.P;
- d) shtetasi R.M.T, lindur më 7.6.1971;
- e) shtetasi A.L;
- f) shtetasi I.S;
- g) shtetasi J.Sh;
- h) shtetasja R.P.

76. Komisioni, bazuar në informacion e ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë<sup>5</sup>, e cila ka informuar se subjekti i rivlerësimit Entela Shedula, gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës në këtë institucion, nuk ka zhvilluar procese gjyqësore me palë ndërgjyqëse sipas

---

<sup>5</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2023.

listës sa më sipër, vlerëson se nuk u provua ndonjë rast që subjekti të ketë gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit.

## **DENONCIME**

77. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë depozituar 12 denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit Entela Shedula, nga të cila 3 janë të përsëritura.

78. Denoncim i shtetasit I.Sh.Z, i depozituar me nr. \*\* prot., datë 8.1.2020, i cili pretendon se ishte në një proces gjyqësor civil në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke u shqyrtuar nga subjekti Entela Shedula. Denoncuesi pretendonte se procesi po zhvillohej pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë që në shtator të vitit 2017 dhe deri në datën e depozitimit të denoncimit ky proces nuk kishte përfunduar. Denoncuesi pretendon se gjyqtarja e çështjes e shtyn procesin në mënyrë të përsëritur.

➤ Në lidhje me këtë denoncim në rezultatet e hetimit, dërguar subjektit në datën 3.3.2020, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

79. Subjekti, në prapësimet e datës 9.3.2020, ndër të tjera, ka shpjeguar se çështja objekt shqyrtimi në bazë të neneve 369 dhe 370 të Kodit të Procedurës Civile, për pjesëtim pasurie, gjykohen në dy faza. Në fazën e parë të tij ka për qëllim të hetojë dhe të përcaktojë të drejtën e bashkëpronësisë së ndërgjyqësve, pjesët takuese të tyre, si dhe sendet që do të pjesëtohen edhe në fazën e dytë gjykata realizon pjesëtimin e pasurisë.

80. Në çështjen konkrete ka rezultuar se për sendin që do të pjesëtohej ishin disa bashkëpronarë, të cilëve nuk u gjendeshin adresat. Për këtë arsye, gjykata ka shtyrë disa herë seancat që të njoftoheshin rregullisht të gjithë bashkëpronarët e pasurisë, si dhe ka proceduar dhe me njoftim me shpallje. Subjekti ka shpjeguar se ka kryer veprimet procedurale, duke respektuar procedurën për njoftimin të palëve në mungesë, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për të garantuar një proces të rregullt dhe ligjor.

81. Referuar procesverbaleve subjekti shpjegon se seancat gjyqësore në asnjë rast nuk janë shtyrë për shkak të gjykatës, sikurse ka pretenduar denoncuesi I.Z, pala paditëse në gjykim. Subjekti ka shpjeguar se seancat gjyqësore janë caktuar brenda afateve të arsyeshme dhe me mirëkuptim të palëve në gjykim. Subjekti ka pretenduar se për sa ka shpjeguar rezulton se provat dhe argumentet e paraqitura vërtetojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit.

### **Vlerësimi i Komisionit**

82. Komisioni, pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit dhe analizimit të provave, konstaton se çështja e shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit me paditës shtetasin I.Z, i cili është edhe denoncues, ka të bëjë me pjesëtimin e një sendi i cili ka 8 bashkëpronarë.

83. Referuar Kodit të Procedurës Civile, konkretisht neneve 369 dhe 370 të këtij Kodi, pjesëtimi i pasurisë kalon në dy faza gjykimi. Në fazën e parë të tij përcaktohet e drejta e

bashkëpronësisë së palëve ndërgjyqëse, pjesët takuese të tyre, si dhe sendi që do të pjesëtohet dhe në fazën e dytë gjykata realizon pjesëtimin e pasurisë.

84. Referuar shpjegimeve të subjektit, si dhe procesverbaleve të seancave gjyqësore, nga gjykata është caktuar ekspert vlerësues privat për të identifikuar sendin objekt gjykimi, si dhe për të përcaktuar pjesët takuese. Gjithashtu, referuar procesverbaleve, rezulton se njoftimi i të gjithë bashkëpronarëve të pasurisë është bërë pengesë për vijimin e gjykimit, për shkak të mosmarrjes dijeni të tyre. Gjithashtu, shtyrjet e seancave janë shkaktuar edhe nga eksperti privat. Sikurse ka shpjeguar subjekti, vonesat janë shkaktuar nga palët në proces edhe nga eksperti, për pasojë shpjegimet e subjektit vlerësohen bindëse dhe të pranueshme nga Komisioni.

### **Mbi një informacion të publikuar nga mediat *online***

85. Komisioni verifikoi informacionin e publikuar në mediat *online* për subjektin e rivlerësimit Entela Shedula, nga ku rezultoi se në vitin 2014 ministri i Brendshëm i asaj periudhe ka denoncuar publikisht pranë Presidentit të Republikës subjektin Entela Shedula, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.4.2014. Në artikull referohet se: *“Gjyqtarja ka liruar shtetasin I.B, akuzuar për vepra të rënda penale dhe se ankesa për gjyqtaren e Kavajës, e cila është pjesë e një sërë vendimesh të dhëna nga gjykatat, të cilat, sipas Ministrisë së Brendshme, mund të konsiderohen flagrante. Bëhet fjalë për veprën penale ‘kanosje me armë’ dhe për të akuzuarin gjyqtarja vendosi detyrim paraqitjeje”*.

86. Në lidhje me këtë Ministria e Brendshme ngriti pretendime, ndërmjet të tjerëve dhe për subjektin e rivlerësimit Entela Shedula, në lidhje me arrestimin në flagrancë të shtetasit I.A.B, për veprat penale “kanosje”, “dëmtime të tjera me dashje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të ftohta”, të parashikuara nga nenet 84, 90 dhe 279 të Kodit Penal. Në shkresë referohet se prokurori i çështjes, z. E.K, kërkoi masën e sigurisë “arrest në burg”, ndërkohë që nga ana e gjykatës me gjyqtar të çështjes znj. Entela Shedula është ndryshuar masa e sigurisë, duke vendosur “detyrim paraqitjeje”.

87. Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë<sup>6</sup> dosjen penale në ngarkim të shtetasit I.B. Nga aktet e dosjes ka rezultuar se në datën 27.11.2013 Policia Gjyqësore ka kryer arrestimin e shtetasit I.A.B, lindur dhe banues në Kavajë, me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “kanosje” dhe “prodhim, mbajtje, blerje apo shitje pa leje e armeve të ftohta” të parashikuara nga nenet 84 dhe 279/2 të Kodit Penal.

88. Në dosje rezulton vendimi nr. \*\*\*, datë 1.12.2013, i subjektit të rivlerësimit Entela Shedula. Pas analizimit të fakteve, provave dhe kërkesave të palëve, rezulton se është vendosur: *“1. Pranimi i kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. 2. Vlerësimi i ligjshëm i arrestimit në flagrancë ndaj personit nën hetim I.B. 3 Caktimi ndaj personit nën hetim I.B si masë sigurimi ‘detyrimin për t’u paraqitur në*

---

<sup>6</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2020.

*policinë gjyqësore, të hënë dhe premten ora 09:00...’, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. 4. Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Durrës...”.*

➤ Në lidhje me praktikën e mësipërme, subjektit në datën 3.3.2020 iu kërkuan shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

89. Subjekti, në prapësimet e datës 9.9.2020, ndër të tjera, ka shpjeguar se në kërkesën për gjykim prokurori i çështjes ka kërkuar të caktohet ndaj shtetasit I.B masa e sigurimit “arrest në burg” me kohëzgjatje 10-ditore, që parashikohet nga neni 245, pika 1, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale, ku në përmbajtje të kërkesës ka sqaruar për të administruar konkluzionet e ekspertimit teknik të kësaj thike.

90. Në gjykim prokurori ka paraqitur në cilësinë e provës edhe aktin “ekspertim teknik thike”, sipas të cilit rezultonte se thika objekt ekspertimi, sekuestruar në ngjarjen e datës 27.11.2013, nuk i plotëson kushtet teknike të armës së ftohtë, e cila u mor dhe u administrua nga gjykata në cilësinë e provës së bashku me aktet dhe provat e tjera. Në gjykim prokurori kërkoi lidhur me caktimin e masës së sigurimit për personin nën hetim “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” çdo të hënë dhe të premte në orën 9:00.

91. Lidhur me caktimin e masës së sigurimit në nenin 244 të Kodit të Procedurës Penale “Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit”, ligjvënësi ka parashikuar se: “1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet/ kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar. 2. Edhe kur gjykata deklaron moskompetencën e vet për çdo lloj shkaku, në qoftë se janë kushtet dhe ekziston urgjenca për marrjen e masës, ajo vendos marrjen e saj dhe i dërgon aktet gjykatës kompetente. 3. Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

92. Për sa më lart, subjekti ka shpjeguar se gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë nga ajo e kërkuar nga prokurori. Gjykata në vendimmarrjen e saj ka zbatuar vetëm ligjin, duke caktuar ndaj personit nën hetim I.B masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

93. Komisioni konstaton se nuk provohen pretendimet e Ministrisë së Mbrojtjes se prokurori i çështjes ka kërkuar për të pandehurin “arrest në burg”, ndërkohë që nga ana e gjykatës, me gjyqtar të çështjes, znj. Entela Shedula, është ndryshuar masa e sigurisë duke vendosur “detyrim paraqitjeje”, pasi ka rezultuar se vetë prokurori i çështjes ka kërkuar në seancë gjyqësore ndryshimin e masës së sigurimit për personin nën hetim nga “arrest me burg” në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

94. Komisioni vlerëson se, referuar edhe nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: “...gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori”, subjekti i rivlerësimit ka vepruar në përputhje me ligjin.

### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

95. Për sa më sipër, sipas germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “e aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

96. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Entela Shedula ka plotësuar së bashku kushtet vijuese:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- b. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të germave “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Entela Shedula, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 27.1.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**

**Kryesuese**

**Suela ZHEGU**

**Relatore**

**Brunilda BEKTESHI**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*

*Etmonda Hoxha*



